



BULETIN MUJOR

TETOR 2025



PËRMBAJTJA

- Shqipëria mikpret Konferencën e NATO-s për Mbrojtjen Kibernetike
- Miratohet Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030 dhe Plani i Veprimit
- Ballkani Perëndimor bashkohet në Tiranë për dialogun rajonal mbi sigurinë kibernetike
- Qeverisja e mirë kibernetike, prioritet për infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme të informacionit
- Shqipëria në Forumin Global të Sigurisë Kibernetike 2025
- Nis Maratona Kombëtare Speciale e Sigurisë Kibernetike

Shqipëria mikpret Konferencën e NATO-s për Mbrojtjen Kibernetike



Në tetor, Shqipëria u bë qendra e diskutimeve mbi mbrojtjen kibernetike, duke mirëpritur Konferencën e NATO-s për Mbrojtjen Kibernetike 2025. Ky event mbledhi përfaqësues të lartë politikë, ushtarakë dhe ekspertë të industrisë nga 32 vendet aleate dhe partnere të Aleancës, për të diskutuar mbi forcimin e qëndrueshmërisë kolektive dhe bashkëpunimit në fushën kibernetike.

Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm i AKSK, z. Igli Tafa, theksoi se siguria kibernetike është një komponent i pandashëm i sigurisë kombëtare dhe aleate, duke nënvizuar angazhimin e Shqipërisë për të kontribuar në sigurinë e përbashkët digjitale të Aleancës



MIRATOHET STRATEGJIA KOMBËTARE PËR
SIGURINË KIBERNETIKE 2025–2030 DHE
PLANI I VEPRIMIT 2025–2027

aksk.gov.al

Miratohet Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030 dhe Plani i Veprimit

Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030 dhe Planin e saj të Veprimit 2025–2027, duke përcaktuar vizionin e Shqipërisë për një ekosistem digjital të sigurt, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Dokumenti, i hartuar nga AKSK, përkon me harmonizimin e politikave kombëtare me direktivën NIS2 dhe standardet e Bashkimit European në fushën e mbrojtjes kibernetike.

Strategjia mbështetet në pesë shtylla thelbësore: forcimin e qeverisjes dhe kapaciteteve kombëtare; mbrojtjen e infrastrukturave kritike; edukimin dhe ndërgjegjësimin publik; zhvillimin e inovacionit dhe kërkimit shkencor; si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Ajo përbën bazën për ndërtimin e një mjedisi të besueshëm digjital që garanton siguri, transparencë dhe qëndrueshmëri për institucionet, bizneset dhe qytetarët.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali
II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



@aksk.gov.al



+355 422 21 039

TETOR 2025

Ballkani Perëndimor bashkohet në Tiranë për dialogun rajonal mbi sigurinë kibernetike

AKSK dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Hollandës, në bashkëpunim me Observer Research Foundation America dhe Albania Sustainable Development Organization, organizuan në Tiranë një dialog rajonal mbi politikat e sigurisë kibernetike.

Aktiviteti mbledhi përfaqësues nga gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, për të diskutuar bashkëpunimin rajonal, reagimin ndaj incidenteve dhe diplomacinë kibernetike. Në fjalën e tij, Drejtori i AKSK-së, z. Igli Tafa, theksoi se sfidat kibernetike kërkojnë veprim të përbashkët dhe investim të qëndrueshëm në kapacitete, duke e vlerësuar dialogun si një hap të rëndësishëm drejt forcimit të qëndrueshmërisë rajonale digjitale.

Qeverisja e mirë kibernetike, prioritet për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit

AKSK zhvilloi aktivitetin mbi “Qeverisjen e Mirë të Sigurisë Kibernetike”, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga të gjitha infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit. Gjatë takimit u nënvizua rëndësia e harmonizimit dhe standardizimit të proceseve si themel i mbrojtjes efektive ndaj rreziqeve kibernetike.

Drejtori i Përgjithshëm i AKSK, Igli Tafa, deklaroi se “standardizimi i proceseve është çelësi i mbrojtjes”, duke theksuar se shumë dobësi burojnë jo nga mungesa e teknologjisë, por nga keqqeverisja ose mungesa e koordinimit institucional.



Shqipëria në Forumin Global të Sigurisë Kibernetike 2025

Drejtori i AKSK-së, z. Igli Tafa, mori pjesë në Forumin Global të Sigurisë Kibernetike 2025, zhvilluar në Rijad, ku Shqipëria u vlerësua si një histori suksesi në ndërtimin e qëndrueshmërisë digjitale dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Gjatë forumit, z. Tafa ndau përvojën shqiptare mbi përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, nënvizoi rëndësinë e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në teknologji, si dhe zhvilloi takime dypalëshe me homologët nga Arabia Saudite dhe Omani. Ai diskutoi nxitjen e bashkëpunimit me vendet e tjera të Gjirit, si dhe dakordësoi nënshkrimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare me United States Telecommunications Training Institute (USTTI), duke forcuar më tej rolin e Shqipërisë në ekosistemin global të sigurisë kibernetike.

Nis Maratona Kombëtare Speciale e Sigurisë Kibernetike

AKSK ka nisur një maratonë të veçantë përfshirjeje dhe zhvillimi të aftësive në fushën e sigurisë kibernetike, e dedikuar veçanërisht për individë me nevoja të veçanta.

Pjesëmarrësit angazhohen në trajnime praktike dhe sfida përmes platformës SimSpace, si pjesë e përpjekjeve për të promovuar mundësi të barabarta në teknologji dhe për të identifikuar talente të rinj që kontribuojnë në mbrojtjen kibernetike të vendit.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali
II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039